

SA.RI FIRE SHPK

Adresa: Rr.Fier-Vlore Km13 Levan,2436 Fier,Shqiperi Mobil:069 53 04 014

KONTRATE SHITJE KUOTA KAPITALI

(Baza ligjore:Neni 705 e vijues i Kodit Civil)

Në Fier, sot më datë 07.09.2021 (Dymijë e njëzet e një), në zyrën e shoqërisë të ndodhur në Rr.Fier-Vlore Km13 Levan,2436 Fier,Shqiperi,u paraqiten palët :

1.SAVERIO RICCELLI,i biri i Tommaso, lindur me 04.06.1956 ne Catanzaro,Itali dhe banues ne Pentone,Itali madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar nga Pasaporte me numer YA2062077 , ketu ne cilesine e Ortakut te vetem te **Shoqërisë « SA.RI FIRE »** shpk ,regjistruar me date 29.01.2020,me zyre qendrore ne Fier, Rr.Fier-Vlore Km13 Levan,2436, numer indentifikimi subjekti M02529402J me status Aktiv - **në këtë kontratë “Pala Shitëse”**.

2.GËZIM FERRA, i biri i Hasan-it , lindur me 05.02.1978 ne Levan,Fier dhe banues ne Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar nga Leternjoftim ID me numer 035887854/ H80205021W, **në këtë kontratë“ Pala Blerese ”** .

MEQËNËSE:

-Pala shitese Z.Saverio Riccelli ,ortak i vetem i shoqërisë « **SA.RI FIRE** » shpk me status Aktiv ,person juridik shqiptar me seli ne Rr.Fier-Vlore Km13 Levan,2436 Fier,Shqiperi, numer indentifikimi subjekti M02529402J me kapital themeltar 100.000,00 leke eshte zoterues i 100% te vleres se kapitalit te Shoqërisë dhe nepermjete ketij akti i shet Z.Gezim Ferra 51% te vleres se kapitalit qe ka ne pronesi ne Shoqërisë« SA.RI FIRE » shpk Fier.

-Palet kontraktuese transferimin e titullit te pronesisë te 51 % te kapitali nepermjete Shitjes nga pala Shitese tek pala Blerese e kane miratuar me vendim të ortakeve te shoqërisë .

ATEHERE

meqënëse ekzistojne parashtrimet si më sipër, palët bien dakord dhe lidhin këtë kontratë shitje si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Kontratës

- **Pala shitese z.Saverio Riccelli me vullnet te lire e te plote i shet z.Gezim Ferra 51% të vlerës së kapitalit te zotëruar prej tij në shoqërinë «SA.RI FIRE » shpk per nje shume prej:**
1 Kuota x 51,000 leke = 51,000 leke (pesedhjete e njemije leke)

Transferimi i pronësisë do të bëhet nga pala shitese tek pala blerese duke kaluar respektivisht titullin e pronësisë të 51% te kapitalit te shoqërisë në favor të z.Gezim Ferra, i cili bëhet zotëruar i 51% te kapitalit te shoqërisë dhe ortaku Z.Saverio Riccelli ngelet ortak me pjesemarrje 49 % te kapitalit te shoqërisë. Palet deklarojne se shuma e blerjes prej 51,000 leke, do te likujdohet teresisht brenda zyres se selise se shoqërisë.

Neni 2.

2.1 Palët bien dakord se pronësia kalon menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.2 Palët bien dakort se kuotat janë të lira nga çdo pretendim i të tretëve, nuk janë të rënduara me barrë apo të ketë proces gjyqësor në lidhje me pronësinë e tyre.

Neni 3.

Regjistrimi në QKB

3.1 Pala shiteese autorizon ortakun Z.Gezim Ferra të depozitojë këtë kontratë në QKB, duke shlyer detyrimet e regjistrimit.

Neni 4.

Shpenzimet për përpilimin e dokumentacionit

4.1 Palët bien dakort se pala blerese merr përsipër kryerjen e shpenzimeve të tjera në lidhje me këtë kontratë.

Neni 5.

Të ndryshme

5.1. Kjo kontrate lidhet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Fier.

Neni 6.

Hyrja në Fuqi e Kontratës

6.1 Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere me nënshkrimin e saj.

Neni 7.

Pjesët Përbërëse të Kontratës

7.1 Do ti bashkangjiten kësaj kontrate: kopje dokument identifikimi të palëve, ekstrakte QKB,vendim nr.1 dt 07.09.2021 dhe çdo dokument tjetër janë pjesë përbërëse e kontratës.

Neni 8.

Nënshkrimi i Palëve

8.1 Palet deklarojnë se e kanë lexuar dhe kuptuar çdo pikë të kësaj kontrate, dhe e nënshkruajnë atë pa rezerva dhe me vullnetin e tyre të lirë ne 3 (tre) kopje të barazvlefshme, nga të cilat një kopje për zyrën e QKB, ndërsa kopjet e tjera për palët për ti përdorur nga ata.

PALA SHITESE

Z.Saverio Riccelli

Perkthyes



PALA BLERESE

Z.Gezim Ferra